

SHTETI DHE RAPORTI ME RELIGJONET NË SHQIPËRI (1920-1967)

Me shpalljen e Pavarësisë, qeveria e dalë nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës e ruajti status quo-në e trashëguar nga Perandoria Osmane për çështjet fetare në Shqipëri. Sipas kapitulacioneve, ortodoksët i ruajtën lidhjet me Patrikanën dhe katolikët me Vatikanin, ndërsa myslimanët i shkëputën.

Protektorati i kishës katolike dhe rivaliteti i Vjenës dhe i Romës

Austria kishte avantazh në Shqipëri nga protektorati i saj mbi katolikët, e njohur me traktate të përcaktuara në shekujt XVII dhe XVIII, madje dhe urdhrat e shkollave religjioze, edhe kur ato trajtoheshin nga italianët, hynin në kompetencat e saj.¹

Diskutimi për formimin e shtetit shqiptar përfshiu edhe religjionin. Çështja e protektoratit të katolikëve në shtetin shqiptar që po formohej, përfshiu jo vetëm qarqet katolike dhe konservatore të Romës, Vjenës dhe Vatikanit, por edhe ato politike. Ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, konti Berchtold, analizoi të dy variantet, nëse Shqipëria autonome mbetej nën sovranitetin e Sulltanit, dhe nëse bëhej plotësisht e pavarur.

Nëse mbetej ndonjë lidhje ndërmjet Shqipërisë autonome dhe Turqisë, protektorati i Vjenës mbetej, pasi bazohej në shumë pakte e traktate të lidhura ndërmjet perandorëve austro-hungarezë dhe sulltanëve të Perandorisë Osmane. Po të shkëputej Shqipëria prej Turqisë e të mos mbetej midis tyre asnjë lidhje, prapë protektorati mbetej, sepse dhe në shtetet e krishtera që u shkëputën nga Turqia u mbajt protektorati i kultit edhe pasi ato u shkëputën nga Turqia.

Rivaliteti i Romës dhe i Vjenës do të shfaqej edhe për çështjen e protektoratit të kishës. Ministri i Jashtëm i Italisë, markezi i San Giulianos,

1 Rivista "D'Albania", Luglio 1940, Augusto Torre, *Italia e Albania durante le Guerre Balcaniche* (1912-13), f. 179.

kishte pikëpamjen se protektoratin austriak mbi kultin nuk ua kishin njohur fuqitë e tjera. Por, Berchtold sqaronte se protektorati nuk kufizohej vetëm në disa institute e në disa priftërinj, por përfshinte ushtrimin e lirë të kultit katolik dhe tërë të drejtat tradicionale të kishës katolike. Protektoratin e tyre në Turqi, e sidomos në Shqipëri, Vjena nuk e kishte quajtur si një të drejtë, por si një detyrë që e kishte marrë mbi vete. Ministri i Jashtëm theksonte se opinioni publik në Austri do të zhgënjehej nga qeveria e tij, nëse braktisnin protektoratin, në kohën që po bëhej Shqipëria më vete. Katolikët, sipas Berchtoldit, sido që të ishte puna, do të formonin një pakicë që kishte nevojë për mbrojtje.

Diskutimet për protektoratin e kultit vazhduan edhe pasi u caktua Princ Vidi në krye të shtetit shqiptar.

Gazeta “Temps” e Vjenës shkruante se në qarqet katolike dhe konservatore e kishin pritur me pakënaqësi lajmin e takimit të kontit Berthold me ministrin e Jashtëm të Italisë, për çështjen e protektoratit.² Ato donin që, për të shmangur rrezikun e ftohjes së marrëdhënieve midis dy shteteve aleate, Austro-Hungaria ta linte çështjen e protektoratit të katolikëve në Shqipëri në dorën e Italisë.

Qeveria e Romës mendonte se do të ishte më mirë që të ndahej protektorati sipas viseve të influencës: Austria për Shqipërinë e Veriut dhe Italia për Shqipërinë e Jugut. Mirëpo, ministri i Jashtëm i Austro - Hungarisë kishte ide të tjera. Ai i kishte thënë Princ Vedit se në bisedimet midis Romës, Vjenës e Vatikanit, ishte gjetur mirëkuptimi midis tyre, sipas të cilit,

“Princ Wiedi do të nënshkruante me Selinë e Shenjtë (Papën) një konkordat, duke garantuar të drejta të katolikëve shqiptarë...”³

Lufta botërore do ta pengonte procesin, i cili do të realizohej pas vitit 1920.

Ortodoksët dhe katolikët kishin gjykatat e tyre kishtare dhe administratat fetare, krejtësisht të lira, sipas kapitulacioneve që kishin fituar prej qeverisë osmane. Ato u ruajtën deri kur filloi funksionimi normal i shtetit shqiptar.

Pas vitit 1920, ortodoksët shpallën Kishën Autoqefale Kombëtare të Shqipërisë, ndërsa katolikët vazhduan lidhjet e tyre me Vatikanin.

2 “Përlindja e Shqipërisë”, 26/11 mars 1914. Shkrimi: “Austria e Italia për çështjen e protektoratit të katolikëve”, marrë nga gazeta “Temps” nga Vjena.

3 AQSH, fondi 591, viti 1913, dosja 2/1, f. 308-309, Nr.5748. Shkresë private për Romë, 10 shkurt 1913, Nr. 668, Koncept (Berchtold).

Marrëdhëniet e tyre me shtetin, kisha katolike i rregulloi me anën e konkordatit të lidhur midis Vatikanit dhe qeverisë shqiptare.⁴

Komuniteti Mysliman, shkëputja nga halifati

Ndryshe nga komuniteti katolik dhe ortodoks, Komuniteti Mysliman i shkëputi ligjërisht dhe faktikisht të gjitha lidhjet dhe marrëdhëniet që kishin me halifatin. Kjo situatë vazhdoi edhe në kohën e qeverisë së Esad Toptanit, të Princ Vidit, të Austro-Hungarisë, të Italisë si dhe të qeverisë së formuar nga Kongresi i Lushnjës. Gjykatat civile të shtetit që vareshin nga Ministria e Drejtësisë, administroheshin prej kadilerëve dhe vepronin sipas legjislaturës fetare të islamit.

Në vitin 1923, Komuniteti Mysliman mbajti një kongres në Tiranë, ku mori pjesë edhe përfaqësuesi i qeverisë. Kongresi hartoi Statutin e Komunitetit Mysliman, bëri organizimin e tij, si dhe caktoi kompetencat dhe të drejtat, në pajtim me ligjet.

Komuniteti Mysliman u shkëput plotësisht nga shteti dhe doli si ent më vete, ndërsa gjykatat civile kaluan në dorën e shtetit.

Komunitetit iu lanë kompetenca për të organizuar klerin, funksionarët fetarë dhe shkollat fetare. Gjykatat fetare shërbenin vetëm për çështjet që kishin thjesht karakter fetar, si kurorëzimet, divorcet, trashëgiminë dhe pasojat e tyre, si dhe administrimin e pronave vakëfnore të Komunitetit Mysliman. Komuniteti Mysliman përpilonte buxhetin e tij që e përballonte me të ardhurat e veta dhe me subvencionin që i jepte qeveria komuniteteve fetare.

Komuniteti Mysliman organizoi Medresenë e Përgjithshme dhe medresetë e qarqeve, botoi libra të përkohshëm që predikonin parimet demokratike.

Mirëpo, këto arritje prekën interesat e atyre që kishin qëllim dobësimin e rolit të komunitetit mysliman në shoqërinë shqiptare.

Me ligjin e shpronësimit u prishën varrezat e qyteteve dhe u bënë sheshe publike. Gjyqet e zhvilluara midis komunitetit mysliman dhe personave privatë që vinin dorë mbi pasurinë e komunitetit, fitoheshin nga privatët.

U ndalua të bëhej në shesh ceremonia e Mevludit, ndërsa publiku nuk lejohej të përcillte haxhilerët që shkonin në pelegrinazh, sipas traditës.

U ndalua mësimi i fesë nëpër shkolla, si dhe u mbyllën shkollat private që jepnin mësimë feje.

U shtetëzua shkolla fillore fetare e Komunitetit Mysliman në Tiranë dhe bëhej propagandë antifetare me nxënësit myslimanë të shkollave të shtetit, ndërsa fëmijët e vegjël filluan të vinin në lojë klerin. U prishnin agjërimit me dhunë nxënësve të moshës së madhe dhe detyronin me ligje të rrepta elementin mysliman që të hiqnin qeleshet e vendit e të vinin kapela të huaja.

Kleri në jetën politike. Ndarja e fesë nga shteti

Deri në vitin 1920, kleri nuk kishte rol në zhvillimet politike në vend, por atë vit mbështeti lëvizjen politike të majtë, shoqërinë “Bashkimi” dhe federatën “Atdheu”. Zgjedhjet parlamentare të pas vitit 1921 kishin specifikën e tyre, se u bënë mbi bazën e përkatësisë fetare, megjithatë nuk munguan mosmarrëveshjet edhe midis vetë komuniteteve.

Në Shkodër, klubi katolik, “Djelmnia”, kundërshtonte kandidaturën e at Gjergj Fishtës dhe Luigj Gurakuqit, madje pati mosmarrëveshje të shumta. Klubi iu drejtohej Fishtës e Gurakuqit, duke i njoftuar se nuk i njihnin si përfaqësues të tyre.⁵ Por, me gjithë kundërshtimin e klubit, Fishta e Gurakuqi u zgjodhën deputetë dhe vazhduan aktivitetin politik në parlamentin e kohës.

Shoqëria “Për të drejtat Kombëtare”, i ankohej delegatit apostolik në Shkodër, Ernest Kozzi, për pakënaqësitë që kishte shoqëria në fjalë ndaj ipeshkëve, të cilët nuk i mbanin premtimet që ata vetë i kishin dhënë përpara delegatit apostolik, para priftnisë dhe para përfaqësuesve të popullit. Shkak ishte se kishin hartuar lista kandidatësh të ndryshme nga ajo e miratuar prej tyre. Sipas shoqërisë në fjalë, ipeshkëvit qenë përkrahur prej fretërve françeskanë.⁶

Ndikim pati edhe kleri bektashian. Këshilli Atëror i Bektashinjve, i zgjedhur në mbledhjen e Përmetit, më 20 qershor 1921, vendosi të aderonte në federatën “Atdheu”.⁷

Në kryengritjen e qershorit të vitit 1924, një pjesë e klerit mbështeti grushtin e shtetit të realizuar nga politikanët e majtë dhe garnizonet ushtarake të Shkodrës dhe Përmetit.

Në vitin 1926, disa klerikë katolikë u përfshinë në kryengritjen e Dukagjinit, të cilët u kritikuan nga Papa, madje ai u tërhoqi vëmendjen se

5 AQSH, fondi 132, (Pa vit), dosja 2.

6 AQSH, fondi 132, viti 1921, dosja 8, f. 13-14. Letër e shoqërisë “Për të drejtat Kombëtare”, dërguar më 12 korrik 1921, delegatit apostolik në Shkodër, Ernest Kozzi.

7 AQSH, fondi 152, viti 1921, dosja 89, f. 6.

ishin shtyrë shumë në politikë.

Me vendosjen e monarkisë shqiptare dhe aprovimin e Kushtetutës, religjionet u trajtuan në mënyrë të barabartë dhe u vlerësuan nga mbretëria.

Përpjekje për të ndryshuar përbërjen fetare

Me pushtimin e vendit, në 7 prill 1939, për efekte politike, regjimi propagandonte se do të ruante lirinë dhe fenë, por synonte ndryshimin e përbërjes fetare të popullsisë. Propaganda kundër komunitetit mysliman zhvillohej edhe në faqet e shtypit të kohës. Një pjesë e shtypit italian botoi shkrime kundër fesë islame, me qëllim përçarjen midis myslimanëve, ortodoksëve dhe katolikëve.

Kur edhe këto veprime nuk patën sukses, ata ndërhyjnë drejtpërdrejt në çështjet e komunitetit. Nxisinin përçarjen midis klerikëve, duke i favorizuar disa me të holla dhe ushqime, por vetëm një pakicë e papërfillshme pranoi dhurata të tilla.

Regjimi u grabiste pasurinë vakëfnore, të cilat herë shpronësoheshin me të holla e herë jo. Në vakëfet e grabitura ngriheshin kazerma e baraka ushtarake.

Për të vënë në kontroll Komunitetin Mysliman, Dekret-Ligja e vitit 1942, rrëzonte Këshillin e Përgjithshëm “ose Kongresin” e Komunitetit Mysliman dhe atributet e kryetarit të atij këshilli iu dhanë një trupi kolegjal të quajtur “Këshilli i Ulemave”. Anëtarët e tij emëroheshin dhe shkarkoheshin me Dekret Mëkëmbësor, mbi propozimin e Sekretarit të Shtetit për Drejtësinë, duke marrë më parë pëlqimin e Këshillit të Ministrave.⁸

Gjatë viteve 1940-1942 u dëmtuan një numër i madh xhamish dhe objekte të tjera të myslimanëve si teqe, mekame, pasuri vakëfnore etj. Kështu, vetëm në Libohovë u dëmtuan 5 xhami, 8 xhami në Delvinë, xhamia e Sarandës, 16 xhami në Vlorë, 9 xhami në Elbasan, 7 xhami në Berat etj.⁹ Teqeja e Karbunarës dhe xhamia u dogjën, ndërsa teqeja e madhe në Elbasan u kthye në stallë kuajsh nga ushtria italiane e pushtuesve.¹⁰

8 AQSH, fondi 132, viti 1927, dosja 4. Letër, datë 15 gusht 1927 e delegatit apostolik në Shqipëri, Della Pietra.

*) Plani i Tiranës u drejtua mbi pasuritë e vakëfit. Kështu u zhduk Xhamia e Karapicit me gjithë fushën e saj pa shpërblim, Xhamija e Haxhi Jaçës me fushën e saj e tw tjera.

9 AQSH, fondi Komuniteti Mysliman, viti 1941, dosja 41, f. 4.

10 AQSH, fondi Mëkëmbësia e Përgjithshme, viti 1940, dosja 556, f. 5. Letër e kryegjyshit Salih

Nxitja e sekteve për përçarje. Nxitja e bektashizmit dhe uniatizimit

Pushtuesit u munduan ta realizonin përçarjen dhe copëtimin e islamit duke aktivizuar e mbështetur sektet kryesore islame. Për këtë qëllim, mbështetën bektashizmin për ta vënë përballë Komunitetit Mysliman.

Pjesa tjetër e planit ishte të inkurajohej një lloj predikimi për uniatizimin e të krishterëve të Shqipërisë. Të dyja planet datonin qysh nga çereku i fundit i shekullit XIX, kur konsujt e huaj në territoret shqiptare ishin shumë aktivë në këtë drejtim.

Politika fetare e asaj periudhe është vënë në dukje nga shumë studiues, në kohë të ndryshme, të cilët veçonin punën e disa konsujve në këtë drejtim. Roberto Maroco della Roca, midis të tjerave shkruan:

*“Fesë islame nga ana e pushtuesve italianë do t'i prezantohet bektashizmi me qëllim që ta thyejë kompaktësinë myslimane... Duhet përmendur se sektet kanë qenë ndihmuar vazhdimisht për qëllime të caktuara kundër islamit, sidomos bektashizmi, duke e prezantuar si “fe” më tolerante në krahasim me islamin”.*¹¹

Krahas përçarjes së myslimanëve, synohej bashkimi i të krishterëve nëpërmjet uniatizimit të ortodoksëve. Më 16 gusht 1939, Jakomoni njoftonte Pallatin Kixhi për

“...përvijimin në gjirin e kishës ortodokse shqiptare të një rryme gjithnjë e më të vendosur drejt uniatizimit”.

Nuk ishte “një lëvizje masive”, për shkak të gjendjes shoqërore të Shqipërisë, por një prirje që megjithatë ishte e sigurt. Sipas Jakomonit, kryepeshkopi Kristofor Kisi kishte deklaruar se bashkimin me kishën romake,

*“...popullsia ortodokse do ta pranonte “pa diskutim” po të vendosej nga sinodi i shenjtë shqiptar”. “Objektivi i uniatizimit nuk është krijuar sot, - thoshte Kisi, - ai ka ekzistuar gjithnjë, por deri tani mungonin kushtet politike për ta arritur”.*¹²

Njazi Dede, dërguar Mëkëmbësisë së Përgjithshme, në tetor 1940.

11 Roberto Morozzo della Roca, “Kombësia dhe feja në Shqipëri” 1924-1944, f. 201-214.

12 AQSH, fondi Komuniteti Mysliman, viti 1944, dosja 31, f. 1- 8. Letër e N/Myftinisë së Istokut, 7 mars 1944, Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman Tiranë.

Gjatë viteve 1939-1944 u thellua kriza në vend dhe uniatizimi i ortodoksisë dështoi. Në një analizë të gjerë për krizën e atyre viteve, delegati apostolik në Shkodër, Leone G.B. Nigris, listonte disa shkaqe. Sipas tij, shoqëria bashkëkohore ishte në krizë të thellë e të gjithanshme, sepse kriza ishte filozofike, morale, juridike, sociale, religjioze dhe politike.¹³

Ndalimi i konvertimeve nga Këshilli i Ulemave

Praktikat e konvertimeve fetare kanë qenë gjithnjë të pranishme edhe pas formimit të shtetit shqiptar. Në vitet e luftës pati kërkesa të shumta për konvertime nga religjione të tjera në fenë islame, por Komuniteti Mysliman ishte mjaft i kujdesshëm për ndjeshmërinë e lartë që kishte gjithnjë kjo çështje. Letërkëmbimi i kreut të Komunitetit Mysliman me myftinitë e zonave të ndryshme të vendit na njeht me çështjen në fjalë.

Më 30 janar 1944, kryemyftinia e zonës së Prishtinës shprehej që, megjithëse nuk kishte ndonjë pengim fetar, e parë në pikëpamjen e atdhetarizmit dhe të interesave kombëtare nuk ishte e përshtatshme, pasi do të kishte efekte të mëdha dhe përfundime të hidhura për kombin dhe atdheun. Kryetari i Këshillit të Ulemave të Komunitetit Mysliman, Sherif Lengu, midis të tjerave, e përgëzonte kryemyftininë se mendimi i saj ishte shumë i arsyeshëm dhe me vend, dhe se të gjithë funksionarët fetarë duhet të vazhdonin predikimet e tyre me një vullnet e energji të plotë “për ndalimin e të tilla çështjeve...”¹⁴

Shteti kundër fesë

Me vendosjen e regjimit komunist, në nëntor të vitit 1944, Shqipëria u përfshi në perandorinë komuniste të Lindjes. Partia Komuniste luftoi për çrrënjosjen e botëkuptimit idealist, për pastrimin nga vetëdija e popullit të atyre që i quante “dogma mistike fetare dhe zakone të prapambetura”.

Në fillim të vitit 1950 regjimi nxori ligjin mbi komunitetet fetare, i cili i detyronte komunitetet fetare të vepronin në bazë të statuteve të tyre të miratuara nga shteti. Drejtuesit e klerit duhet të zgjidheshin nga vetë klerikët dhe të miratoheshin nga qeveria, ndërsa në veprimtarinë me besimtarët klerikët duhet të predikonin besnikërinë ndaj regjimit. Qeveria

13 Leone G.B. Nigris- “*L’Oriente cristiano e Roma*”, Grottaferrato 1942, f. 19-20.

14 AQSh, fondi i Kryeministrisë, viti 1950, dosja nr. 2193.

hartoi edhe një projektstatut, të cilin duhej ta miratonin komunitetet fetare, në mbledhjet e përgjithshme të klerikëve.

Konferenca e klerikëve të Kishës Ortodokse, mbajtur më 5 deri në 10 shkurt 1950 dhe në të cilën bënë pjesë 48 delegatë, kundërshtoi projektstatutin e qeverisë dhe u përpoq të ruante pavarësinë e lidhjet me kishat ortodokse jashtë vendit.¹⁵ Mirëpo, për regjimin, kjo do të thoshte shtet brenda shtetit.¹⁶

Rezistencën më të madhe regjimi e pati nga kleri katolik, i cili e kundërshtoi masivisht projektstatutin e ri. Në mbledhjen e Arqipeshkvisë në Shkodër, që u mbajt në nëntor të vitit 1950, merrnin pjesë 56 delegatë nga kishat e vendit. Atje pati shumë kundërshtime, sidomos për nenin 13 të statutit të ri, që ndalonte vartësinë e kishës katolike nga Vatikani dhe zgjedhjen e arqipeshkvit nga Papa.¹⁷

Për të thyer kundërshtimin e klerit katolik, regjimi futi përçarjen midis klerikëve. Për këtë qëllim përdori klerikët e fshatrave, të cilët i sqaroi se

*“... besimi i tyre te Zoti mund të bëhej edhe pa vartësinë nga Vatikani”.*¹⁸

Përçarjen e klerikëve katolikë, regjimi e konsideroi sukses të madh. Pjesa më e madhe e klerikëve e pranuan statutin e propozuar nga qeveria. Kleri i ulët i fshatrave ishte për statutin ri, ndërsa kleri i lartë, me në krye Marin Serdanin, e kundërshtoi atë. Me statutin e ri hiqej çdo varësi nga Vatikani dhe Papa.¹⁹

Edhe komuniteti mysliman dhe ai bektashian e miratuan projektstatutin e propozuar nga qeveria.

Plenumi III i Komitetit Qendror të Partisë, në tetor të vitit 1949, udhëzonte komunistët se feja nuk mund të luftohej menjëherë, por nëpërmjet një lufte të vazhdueshme revolucionare.²⁰

15 AQSh, fondi i Kryeministrisë, viti 1950, dosja nr. 2193.

16 Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 8, f.147.

17 AQSh, fondi i Kryeministrisë, viti 1950, dosja nr. 2200.

18 AQSh, fondi i Kryeministrisë, viti 1954, dosje nr. 1123.

19 Turhan Shilegu, *“Lufia e klasave nu Shqipëri 1948-1953”*, f. 195-198.

20 Enver Hoxha. *“Vepra”*, v. 6, f. 356.

Lufta kundër klerikëve “reaksionarë”

Partia Komuniste i ndante klerikët në tri kategori. Një pjesë ishte e lidhur me regjimin dhe mbështeti masat e tij kundër fesë, një kategori qëndroi e heshtur, ndërsa kategoria e tretë kundërshtoi masat e regjimit për luftën kundër fesë.²¹

Duke bërë një politikë diferencuese dhe përçarëse në radhët e klerikëve, regjimi i goditi të gjithë klerikët që i quante “reaksionarë” dhe që sipas tij, “zhvillonin veprimtari armiqësore ndaj pushtetit popullor dhe revolucionit ideologjik socialist”.

Vitet 1945-1948 ishin mjaft të ashpra në goditjet kundër klerikëve “reaksionarë të tri besimeve. Pati shumë të ekzekutuar, ndërsa një numër i madh përfundoi në burgje. Në vitin 1948, vetëm në zonën e Shkodrës, u ekzekutuan tetë priftërinj katolikë.²² Shtypi i regjimit bëri fushatë të madhe propagandistike, për të bindur opinionin publik sikur ata ishin “armiç”.

Në shkurt të vitit 1951, Partia Komuniste nxiti luftën e ashpër kundër klerikëve “reaksionarë”, duke theksuar:

*“Ne kurrë nuk duhet ta zbutim luftën kundër krerëve të klerit, që janë kundër Partisë e pushtetit tonë, të mos harrojmë kurrë se ata nuk bëhen miq me Partinë”.*²³

Regjimin e shqetësonte rritja e autoritetit të fesë, me gjithë masat e marra deri atëherë për goditjen e saj. Në një relacion të Drejtorisë së Parë të Sigurimit të Shtetit, që mban datën 10 shtator 1957, mbi aktivitetin e klerit katolik në Qarkun e Shkodrës, midis të tjerash theksohej se kleri katolik me anën e festave të ndryshme fetare tërhiqte në kishë shumë besimtarë dhe sidomos nga masa e rinisë. Sigurimi i Shtetit veçonte rastin e festës fetare “Zoja e Shkodrës” ku, në valën e punimeve bujqësore ato kishin grumbulluar te kisha afër Urës së Baçallëkut shumë fshatarë nga periferia, për të festuar. Po kështu, përmendeshin ditët e pagëzimit të fëmijëve nga mosha 6-12 vjeç, që bëheshin në qytetin e Shkodrës, të Lezhës etj., festa këto që në të shumtën e rasteve kryesoheshin nga monsinjor Ernesto Çoba.²⁴

21 AQSH, fondi 14/APOU, viti 1967, dosja 190, f. 38. Raport informativ mbi rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa për thellimin e mëtejshëm të saj.

22 AMPB, fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dosja 9, f. 25. Lista e ish- klerikëve që janë pushkatuar për veprimtari armiqësore; Sekret, Shkodër, më 22.12.1978.

23 Enver Hoxha, “Vepra”, vëll. 8, f. 159-160.

24 AMPB, fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dosja 9, f. 262. Relacion, datë 10.9.1957,

Mbyllja dhe shembja e objekteve fetare

Lufta kundër religjioneve përfshinte edhe luftën kundër objekteve të kultit. Ndalimi i besimit fetar dhe prishja e objekteve të kultit, në vitin 1967, u parapri nga një fushatë propagandistike ateiste që zgjati disa vjet.

Në korrik të vitit 1966, regjimi njoftoi arqipeshkvin Ernest Çoba se shenjtorja e Zojës që ndodhet në rrugën nacionale, përbri kalasë së Rozafatit, do të përfshihej në zonën ushtarake. Arqipeshkvi iu drejtua kreut të regjimit për ta pezulluar këtë vendim, por pa rezultat.²⁵

Në janar të vitit 1967, strukturat e regjimit në bazë u kërkuan klerikëve të dorëzonin me dëshirë objektet e kultit për t'i transferuar në godina dëfrimi për rininë.²⁶

Në 6 shkurt të atij viti, kreu i regjimit mbajti një fjalim, i cili shërbeu si nxitje për shpërthimin e një lëvizjeje revolucionare ku të rinjtë shkruanin fletë rufe kundër kishave, xhamive dhe klerikëve të tyre. Kishat u zhveshën nga ikonat dhe materialet e tjera, të cilat u morën nga shtabet e rinisë, ndërsa klerikët u përzhunë nga objektet fetare.²⁷

Më 13 shkurt 1967, kryetari i Komitetit Bektashian, një përkrahës i regjimit, i shkruante Komitetit Qendror (KQ) të Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH) se u bënte thirrje të gjitha institucioneve fetare të tjera të vendit që të ndiqnin shembullin e gjyshitës së Fushë - Krujës. Ai e garantonte KQ-në e PPSH-së dhe veçanërisht Enver Hoxhën se,

*“...do të ishin deri në vdekje besnikë të vijës revolucionare të Partisë së lavdishme dhe heroike”.*²⁸

Nën udhëzimet e kryegjyshit, personeli laik e klerik i gjyshitës së Fushë- Krujës kishte marrë iniciativë për kthimin e qendrës fetare në qendër edukative kulturore dhe dorëzimin e pasurisë së saj kooperativës “Partizani” të Fushë-Krujës.

Nën presionin e ateistëve, Këshilli i Përhershëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Komuniteti Bektashian, në 18 shkurt 1967, vendosën që të gjithë klerikët myslimanë të Shqipërisë të tërhiqnin vullnetarisht uniformën fetare dhe të visheshin civilë. Në të gjitha rrethet, myftinitë i konsideruan të panevojshme, ndërsa zyrat e tyre nëpër rrethe

Mbi aktivitetin armiqësor të Klerit Katolik në Qark.

25 AQSH, fondi 14/APSTR, viti 1966, dosja 248, fl. 3. Informacion mbi telegramin e Ernest Çobës, datë 16. VII. 1966.

26 Po aty.

27 AQSH, fondi Kisha Autoqefale e Shqipërisë, viti 1967, dosja 1371, f. 1.

28 Po aty.

iu dorëzuan regjimit.

Xhamitë dhe teqetë e tepërta iu lanë në dispozicion pushtetit për t'i përdorur sipas nevojave, ndërsa tyrbet iu lanë masave të popullit t'i përdornin si të donin.

Ata ndaluan edhe thirrjen e ezanit në minaret në të gjitha xhamitë e Shqipërisë. Po kështu, ndaluan klerikët që të bënin ceremoni fetare private në faltore, familje e kudo.²⁹

Më 26 shkurt 1967, Enver Hoxha udhëzonte komitetet e PPSH-së të rretheve të vepronin kundër fesë dhe klerit. Asnjë ndërtim të mos u bëhej kishave dhe xhamive që po rrënoheshin. Disa mund të ktheheshin në vepra- muze, në qoftë se ishin të tilla, disa që donte populli do të bëheshin depo.

“Tash është çështja t’u prishen kishat dhe xhamitë,

- theksonte Enver Hoxha,

- të vetmet mjete kryesore ku klerikët grumbullojnë besimtarët për të mbajtur gjallë besimin”.³⁰

“Prishja e kishave, xhamive, teqeve e manastireve paraqiste vështrësi, prandaj në këtë drejtim,

- vinte në dukje Enver Hoxha,

- duhet pasur kujdes e takt”.

Por mjaft prej tyre ishin prishur “pa ngjallur asnjë reaksion”, disa të tjera kishin rënë, kishte nga ato që ishin kthyer në depo ose kishin mbetur pa hoxhë apo pa prift dhe praktikisht nuk funksiononin.

“Me këto forma duhet të vazhdojmë ne derisa t’i rrafshojmë ato nga faqja e dheut”,

- theksonte Enver Hoxha.

Objektet e mëdha fetare ishin në përgjithësi në qendrat e qyteteve. Ato ndikonin psikologjikisht mbi njerëzit, pasi ruanin pamjen e jashtme si kishë apo si xhami. Për të zhdukur gjurmët tyre, regjimi udhëzonte që disa prej tyre

“që pengonin planimetrinë e sotme e të ardhme të fshatrave apo

29 AQSH, fondi Komuniteti Mysliman, viti 1967, dosja 22, f. 1. Vendim nr. 2, datë 18.2.1967, i Këshilli i Përhershëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

30 AQSH, fondi 14/APOU, viti 1967, dosja 190, f. 1-9; Nr. 133 prot., Tepër sekret, Tiranë 27. II. 1967, Komiteteve të Partisë së Rretheve.

qyteteve”, të prisheshin, “duke marrë si gjithnjë mendimin e popullit dhe ku ka mundësi të bëhen ndërtime të reja”.³¹

Për t' i dhënë luftës karakter popullor, sikur kinse objektet e kultit po i prishte populli, regjimi aktivizoi rininë e shkollave të mesme dhe të larta. Në zbatim të udhëzimeve të Enver Hoxhës, në të gjithë vendin u mbyllën të gjitha kishat, xhamitë, teqet, tyrbet, vakëfet etj. Ky numër arriti gjithsej në 2169, nga të cilat 740 xhami, 608 kisha ortodokse e manastire, 157 kisha katolike, 530 teqe, tyrbe, mekame etj. Bashkë me institucionet fetare u morën në dorëzim edhe pasuria e tyre.

Shumë kisha, xhami dhe teqe u rrafshuan përtokë, ndërsa një pjesë e tyre u kthyen në depo. Edhe librat fetarë dhe shkencorë që u gjetën në to, u dogjën. Vetëm një pjesë e vogël u kthyen në muze. Klerikët që u deklaruan kundër u arrestuan dhe u dënuan.

“Këtu nuk ka asnjë shtytje, asnjë presion, qoftë edhe sugjerim nga ana e shtetit”,

- justifikohej Enver Hoxha.

Ai theksonte:

“Kjo është krejtësisht një iniciativë e tyre. Kur e kërkon rasti, të shpjegohet që kjo është iniciativë e vetë klerikëve, sepse elementët armiq mund ta përdorin këtë kundër pushtetit”.

“Edukimi” ateist i masave, formimi i “njeriut të ri”

Që kur erdhi në pushtet, Partia Komuniste e Shqipërisë u kujdes për edukimin ateist të masave dhe krijimin e njeriut të ri. Më 6 mars 1946, regjimi vendosi mbylljen e seminareve françeskane dhe jezuite, si dhe të gjitha instituteve shkollore të mbajtura dhe të drejtuara prej klerit katolik. Gjithashtu, u shpërndanë organizatat e shoqëritë e ndryshme si dhe u ndalua veprimtaria fetare e tyre. U bë rekuizimi i gjithë pronës së luajtshme e të paluajtshme të tyre dhe u konfiskua gjithë pasuria e Urdhrit Jezuit.³²

31 AQSH, fondi 14/APOU, viti 1967, dosja 190, f. 38.

32 AQSH, fondi 490, viti 1946, dosja 458, fl. 4. Vendim nr. 14, datë 6 mars 1946 i Këshillit të Ministrave. Enver Hoxha, “Vepra”, vëll. 8, f. 159-160.

Në tetor të vitit 1949, Partia deklaronte se

“njerëzit e popullit, qofshin edhe besimtarë, janë miq të Partisë, prandaj ajo do të punojë dalëngadalë dhe me bindje, derisa t’ua shkullë besimin ndaj zotit, kishës, fesë”.³³

Krahas ndalimit të organizatave fetare, Partia e Punës forcoi organizatat e krijuara prej saj si: Fronti Demokratik i Shqipërisë (FDSH), Bashkimi i Grave të Shqipërisë (BGSH), Bashkimi i Rinisë së Punës së Shqipërisë (BRPSH), Bashkimet Profesionale të Shqipërisë (BPSH) etj.

Pasi i përdori gjatë kolektivizimit të bujqësisë, në vitet 1950, regjimi do t’i përdorte këto organizata edhe më shumë në luftë kundër fesë. Në 3 prill 1962, Sekretariati i KQ-së të PPSH-së mori vendim për intensifikimin e propagandës ateiste.

Detyra kryesore i vihej Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, me qëllim që të kishte më tepër tregime, skeçe, pjesë teatrale, skica etj. Gjithashtu, Lidhja duhej të aktivizonte më shumë njerëzit e letërsisë dhe arteve në qendër dhe në rrethe, si dhe redaksitë e shtypit dhe Radio-Tiranës.

Një rol i rëndësishëm iu ngarkua shkollës, ndërsa tërheqja e të gjithë masës së arsimtarëve dhe intelektualëve të tjerë në propagandën ateiste - shkencore duhej të konsiderohej si një nga detyrat themelore.

Ministria e Arsimit dhe Kulturës u ngarkua të kishte kujdes për përgatitjen e arsimtarëve me frymën ateiste në shkollat pedagogjike, në kurset e ndryshme, apo edhe në seminarët me punonjësit e kulturës.

Propagandës ateiste i shërbenin edhe lufta kundër zakoneve, që Partia e Punës i quante të këqija si dhe bëhej vetëm organizimi i festave si Viti i Ri, 1 Maji, 28-29 Nëntori etj. Festa të tilla si ajo e pranverës, e të korrave, martesat, datëlindjet, etj., sipas Partisë, duhej të zhvisheshin nga lëvorja fetare dhe t’u jepej karakter popullor.

Duhet të organizoheshin mbrëmje dëfrimi, piknikë, etj., që të rinjtë të mos e ndjenin nevojën për të vajtur në faltore dhe në panaire fetare.

Zbatimi i vendimeve të Partisë së Punës përgatiti terrenin për goditjen përfundimtare të fesë. Më 27 shkurt 1967, KQ-ja e PPSH-së iu dërgoi një letër komiteteve të partisë së rretheve *“Mbi luftën kundër fesë, paragjyqimeve dhe zakoneve prapanike”*. Enver Hoxha theksonte në këtë letër:

“Ne nuk kemi lënë asnjë nga shkollat, qoftë edhe të ulëta, nga dilnin klerikët e rinj për të interpretuar doktrinën e tyre fetare. Kështu që

klerikët e çdo besimi në vendin tonë kanë shteruar vazhdimisht si kuadro. Kurse për sa i përket botimit të librave e të dogmave të tyre, kjo ka vdekur me kohë për ta”.

Në korrik, regjimi bëri një bilanc në luftën kundër fesë dhe mori masa për thellimin e mëtejshëm të luftës kundër saj.

Lufta kundër fesë zhvillohej në front të gjerë në qytet dhe në fshat, në të gjitha shtresat e popullit. Ajo dallohej nga aksione jo vetëm kundër fesë si botëkuptim, por edhe kundër bazave që kishin ruajtur fenë.

Në luftë kundër fesë mori pjesë masa e popullit që mbështeste regjimin, i cili propagandonte “kotësinë dhe dëmin e besimeve fetare”. Regjimi theksonte se demaskimi i fesë në aspektin politik jepte më shumë rezultate nëse e nxirrnin fenë si “vegël në duar të armiqve të popullit brenda dhe jashtë vendit”. Propaganda në këtë drejtim ishte më e kapshme për masat e popullit dhe i largonte ato më shpejt nga feja.³⁴

Rol të madh në luftën kundër fesë luajtën shtypi qendror dhe ai lokal, radioja, institucionet kulturore etj., të cilat e mbështetën, propaganduan dhe e ushqyen mirë lëvizjen e masave.

Për të arritur deri në fund luftën për çrrënjosjen e besimeve fetare, regjimi dha disa udhëzime, si më poshtë:

- Shtypi qendror e lokal duhet të vazhdonte të trajtonte luftën kundër fesë.
- Të shtohet literatura antifetare dhe të rritej tirazhi i botimeve me këtë temë.
- Shkollat të formonin brezin e ri me botëkuptimin materialist dhe antifetar.
- Institutet si ai i folklorit, i historisë e gjuhësisë etj., të bënin studime për të treguar “rolin reaksionar të fesë në të gjitha fushat”.
- Teatrot, estradat dhe kinostudioja “Shqipëria e Re” t’i jepnin vend më mirë demaskimit të rriteve e zakoneve fetare dhe të propagandonin normat e reja socialiste.
- Ministria e Arsimit dhe Kulturës dhe institucionet që vareshin prej saj të hapnin ekspozita me fotografi e materiale që demaskonin fenë.
- Inteligjenca të lozte një rol më të madh në propagandën ateiste.

³⁴ AQSH, fondi 14/APOU, viti 1967, dosja 190, f. 38. Raport informativ mbi rezultatet e para të luftës kundër fesë dhe disa masa për thellimin e mëtejshëm të saj.

Çdo komunist, duhej të ishte ateist sepse, sipas Partisë së Punës së Shqipërisë, botëkuptimi fetar ishte i papajtuashëm me botëkuptimin marksist-leninist, që përbënte bazën ideologjike të Partisë.

Ndalimi i festave fetare

Politika e formimit të njeriut të ri përfshiu edhe ndalimin e festave fetare si: Krishtlindja, Bajrami, Pashkët dhe datat e tjera që përcaktonte kalendari fetar. Zhdukja e praktikave fetare dhe zakoneve tradicionale, krijonte boshllëk shpirtëror te njerëzit dhe për ta mbushur atë, regjimi i zëvendësoi me festa dhe zakone të reja.

Si festa me karakter kombëtar, Partia caktoi 11 Janarin, që ishte Shpallja e Republikës, 1 Majin, 8 Nëntorin (themelimi i PKS-H-së), 28-29 Nëntorin.

Festa me karakter shoqëror u caktuan të tilla si Viti i Ri, 7 Marsi, 8 Marsi, 25 Prilli (Dita e Kufirit), 5 Maji (Dita e Dëshmorëve), 1 Qershori (Dita e Fëmijëve), 10 Korriku (Festa e Ushtrisë) etj.

Partia udhëzonte të kremtoheshin si festa lokale datat e ngritjes së organizatave të partisë, të rinisë, të këshillave nacional-çlirimtare, të rënies së dëshmorëve, krijimi i kooperativave, shtetëzimi dhe ngritja e fabrikave dhe ndërmarrjeve të reja, Dita e Minatorit, Dita e Naftëtarit, Dita e Verës në Elbasan, Dita e Notit në Durrës etj.

Regjimi lejonte të festoheshin edhe festa familjare, të tilla si ditëlindja, hyrja në shkollë, hyrja në organizatën e pionierit, në rini, në parti, në ushtri, dhënia e fletë lavdërimit, dekoratave etj. Partia udhëzonte që, në këto festa duhej të merrnin pjesë edhe pjesëtarë nga kolektivi etj.

Partia merrej edhe me fejesat dhe martesat e të rinjve:

“Sa do të ftojë në fejesë apo martesë, këtu recetë nuk jepet. Recetë është vetëm porosia e partisë që të mos bëhet ky gëzim shkak i dëmtimit dhe shkatërrimit të ekonomisë. Kuptohet se kur nusja është larg, ajo do të merret qoftë me kuaj, qoftë me taksi. Ditën e dasmës nusja të vishet sa më bukur e hijshëm”.

Për të varrosur të vdekurit, nuk lejohej prania e klerikëve, pasi duhej zhvilluar lufta kundër fesë.³⁵

35 AQSH, fondi 14/APSTR, viti 1967, dosja 191, f. 4. Mbi zëvendësimin e praktikave dhe zakoneve fetare të jetës së përditshme të njerëzve me ceremoni dhe festat socialiste.

Rezistenca për mbrojtjen e fesë

Ndryshe nga çfarë propagandonte regjimi, prishja e objekteve të kultit kishte ngjallur rezistencë të shumica e klerikëve dhe në popull. Që në ditët e para të luftës së regjimit kundër fesë, pati edhe rezistencë për mbrojtjen e saj. Një numër i madh klerikësh, i të tre besimeve, të konsideruar nga regjimi komunist si reaksionarë, u sakrifikuan për besimin dhe fenë e tyre.

Më 12 mars 1963, flitej se xhamia e katundit Laknas të rrethit Tiranë do të kthehej në dhomë kulture dhe xhemati kishte deklaruar se po të prishej xhamia ishin gati të përdornin edhe forcën.³⁶

Kryepeshkopi Paisi i shkruante kryeministrit Mehmet Shehu, se në ceremoninë e Pashkës të atij viti (3 maj 1964), kishin hyrë në kishën katedrale të Beratit, 2-3 nënoficerë të Policisë Popullore. Njëri prej tyre, në prezencë të Episkopit të Dioqezës, i cili kryesonte meshën, iu afrua altarit dhe deshi të arrestonte priftin, nën pretekstin e rënies së kambanës në orar të ndaluar, gjë që u evitua me ndërhyrjen e besimtarëve.

Në katundet e Lushnjës, kishin ndodhur ngjarje të papëlqyera, më e rënda në Divjakë, ku ishte thirrur prifti prej sekretarit të Organizatës Bazë të Partisë, në prani të kryetarit të Këshillit Popullor e të personave të tjerë e ishte urdhëruar të mos i binte kambanës dhe të mos meshonte në kishën qendrore. Natyrisht që prifti nuk iu bind, por kambanës nuk i binte më.³⁷

Më 30 dhjetor 1964 prifti Simon Ndreka ankohej tek Enver Hoxha se një repart ushtarak kishte hyrë në kishën e katundit Guri i Zi, Rrenc, Gajtan, kishin prishur materialin që kishte brenda në kishë dhe e kishin kthyer në kazermë. Kjo e kishte prekur thellë, atë si klerik si dhe besimtarët.³⁸

Xhemati dhe besimtarë të qytetit të Elbasanit, në vitin 1965, ankoheshin për punëtorët që kishin shkuar të prishnin xhaminë “Ballije”, që ata e quanin një xhami historike.³⁹

Sekretari i Parë i Partisë në rrethin e Shkodrës kishte fituar urrejtjen e popullit. Kishte prishur kisha e xhami, dhe disa prej tyre ishin kthyer në depo shtetërore. Kishte ndaluar rënien e kambanave, jo vetëm për festat fetare, por edhe për të treguar sa ishte ora.⁴⁰

36 AQSH, fondi 14/APSTR, viti 1963, dosja48, f. 16. Letër e kryemyftiut të Zonës Tiranë dërguar Kryesisë së Komunitetit Mysliman, nr. 11 prot., datë 12. 3. 1963.

37 AQSH, fondi Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, viti 1964, dosja 1228. Letër e Kryepeshkopit Paisi dërguar kryeministrit Mehmet Shehu, më 14.8.1964.

38 AQSH, fondi 14/APSTR, viti 1965, dosja 968, f. 1.

39 AQSH, fondi 14/APSTR, viti 1965, dosja 1014. Letër protestë dërguar Enver Hoxhës nga xhemati dhe besimtarët e Elbasanit për vendimin e prishjes së xhamisë “Ballije” në Elbasan.

40 AQSH, fondi 14/APSTR, viti 1965, dosja 1014.

Regjimi mori masa të ashpra kundër atyre që rezistuan edhe pasi prishi objektet fetare. Vetëm në zonën e Shkodrës, gjatë periudhës prill 1967 - prill 1969, u dënuan 13 klerikë. Prej tyre, 3 u dënuan me vdekje, ndërsa të tjerët nga 13 deri 25 vjet heqje të lirisë. Akuza: “Për veprimtari armiqësore të zhvilluar në dëm të pushtetit popullor dhe rendit socialist në Shqipëri”! Shtatë të tjerë u demaskuan.⁴¹ Vite më pas, midis të arrestuarve të shumtë do të ishte edhe monsinjor Ernest Çoba, i cili do të vdiste në burg.

Me gjithë masat e ashpra kundër fesë, klerikëve dhe besimtarëve, shteti nuk e mposhti dot religjionin. Objektet e kultit u ringritën më të mira se më parë dhe besimtarët i mbushën përsëri. Ishte betejë e humbur e shtetit kundër fesë dhe klerikëve, që u kushtoi shqiptarëve humbje të mëdha.